



Prishtinë, 24 shtator 2018  
Kodi i ZRRE-së: V\_1034\_2018

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 25 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në Burimet e Ripërtritshme të Energjisë;
- Nenin 18, 19 dhe 20 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve;
- Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vet-konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në Lokacionin Llapnasellë, ZK Llapnasellë, me kapacitet të instaluar prej 95 kW në Komunën e Graçanicës, të datës 05.09.2018 me nr. prot. 397/2018 të N.T. "Liridoni" me adresë: Magjistranja Pejë – Deçan, Komuna Pejës, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur më 24 shtator 2018 nxori këtë:

**V E N D I M**

**PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM**

- I. **APROVOHET** kërkesa e N.T. "Liridoni", për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vet – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në Lokacionin Llapnasellë, me kapacitet të instaluar prej **95 kW**, në ngastrat kadastrave Nr. 1888/15 ZK Llapnasellë, Komuna e Graçanicës.
- II. **OBLIGOHET** - N.T. "Liridoni", me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DFE-9018259, që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vet-konsum, të parashtrij kërkesë në KEDS SH.A., për pranimit teknik të objektit energjetik.
- III. ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas pëqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.
- IV. N.T. "LIRIDONI", do të lidh Marrëveshje për vet-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimit teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse.



## Arsyetim

- ZRRE, me datë 05.09.2018 nga N.T. "Liridoni", ka pranuar aplikacionin për marrjen e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vet – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në Lokacionin Llapnasellë, me kapacitet të instaluar prej **95 kW**, në ngastrat kadastrave Nr. 1888/15 ZK Llapnasellë, Komuna e Graçanicës.
  - N.T. "Liridoni", s'bashku me aplikacioni ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetorë të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të instaluara, pëlqimin elektroenergjetik nr. 8406 të datës 13.08.2018 të lëshuar nga KEDS S.H.A., dhe Pëlqimin nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Graçanicës.
  - Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së N.T. "Liridoni" dhe dëshmime të bashkangjitura, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vet-konsum nga panelet solare/fotovoltaike në Lokacionin Llapnasellë, me kapacitet të instaluar prej **95 kW**, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

Arsim Janova, u.d kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës,
- Komunës së Graçanicës,
- KEDS SH.A.,dhe
- Arkivit të ZRRE-së.